



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:191066
Datë: 27.09.2024
Numri i dokumentit: 06223759

C.nr.3243/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtarja Dora Bajrami, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.M. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. B.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Illyria”, me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit, jashtë seancës, më datë 27.09.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET e tërhequr padia C.nr.3243/2022 e datës 19.09.2022, parashtruar nga paditësi A.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi A.M. nga Prizreni përmes të autorizuarit të tij av. B.M. nga Prizreni kësaj gjykate me dt. 19.09.2022 ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Illyria”, me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit.

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, gjykata me dt. 22.07.2024 nga përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse, av. B.M. ka pranuar parashtresën e datës 19.07.2024, përmes së cilës ka njoftuar gjykatën se e tërheqin padinë në këtë çështje juridike kontestimore, pasi që palët ndërgjyqëse kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore.

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet që të konstatohet e tërhequr padia e paditësit, në përputhje me nenin 261 të LPK-së. Kështu, në nenin 261 par. 1 të LPK-së theksohet që *“paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”*. Pastaj, me nenin 261 par.2 të po këtij neni thuhet, *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*, të paditurës i ka dërguar njoftimin për tërheqjen e padisë, me datë 25.07.2024, mirëpo e paditura edhe pas pranimit të njoftimit me dt. 31.07.2024 nuk është deklaruar për tërheqjen e padisë, rrjedhimisht mos deklarimi i të paditurës për gjykatën është konsideruar si pëlqim i dhënë për tërheqjen e padisë.

Numri i lëndës: 2022:191066

Datë: 27.09.2024

Numri i dokumentit: 06223759

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së, që secila palë t'i bartë shpenzimet e saj procedurale.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 261 dhe 387 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.3243/2022, datë 27.09.2024

Gj y q t a r j a

Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa në kuptim të nenit 261 par. 4 të LPK-së.